shpëton. Bualli: shënon njeri të fortë. Viçka, shqera: evlat. Dhentë, dhitë: hallall mall. Dashi: nderim. Kurbani: shpëtim.

* * *

Kush sheh këndes: sheh hajir nga dijetarët. Pula, rosa, pata: shënojnë grua të mbarë. Pul e zezë: evlat. Zënkë këndezi ose dashi: e quajnë luftë. Bilbili shënon evlad të mënçëm. Rabecka: foshnjë të mënçëm. Shqiponja: shënon mashkull edhe nderim. Gala: hidhërim. Zënkë me galë: del zënkë me të liqtë. Foleja: shënon grua: veza evlat.

* * *

Flutura që rethon pas flakës: shënon dashuri. Mushica: gjakpirës: Pijavica: bij edhe fëmij. Zhaba hajir. Breshka shënon grua të mirë. Miz' e dheut jetë të gjatë. Merimanga: person lavdëronjës. Bleta: fitim. Matka: gëzim edhe besim. Po të kafshoj grera: ke dënim.

* * *

Peshku: shënon mall. Prej peshkatarit e mara peshk: shënon martesë. Peshku në ujë: hajir. Në të thatë: jo mirë. Leq i peshkut: hile. Prej barkut të peshkut e nxjera inxhi: del evlat me mirveti (ZOTI me dije plot: e din ma mirë).

* * *

Kur sheh gjymtyra, leshra, mjekra, ëndra ç' kuptim ka?

Dora, këmba, syri, veshi, hunda, goja, gishti, shënojn bijë. Gjymtyrë: shënon ndarje nga fëmija dhe nga dheri. Duart e hapët: xhymertllëk. Duart e mbyllur: neqesllëk. Prej dorës e dala zjar: për dijetarët dituri. Për kryetarët: del fuqi. Dor' e djathtë: shënon mashkull. Dorë e mëngjër: shënon femër. Po të shohish dorën e prerë: bëj tobe. Gjishtërinjtë shënojnë mjeshtëri edhe të pes kohët lavdërim. E kafshuara ose e prera gjishtërin: të del dëshpërim. E ngjyrosura dorën me gjak: hidhërim. Thonjtë: përparim. Këmba zbathur: mundim; dhemka e kryesë: bëj tobe pa vonesë. Brija: fuqi. E para vehten me bri: prapësi. Vetulla: naltësi. Koka: kosuni.

Lesh i kokës: shënon jetë të gjatë. Po erëna leshi: s'ka fat të mirë. Po t'a shohish gruanë me lesh të hapët: bur i saj largohet. E qethura kryenë: shënon besim të fortë edhe shpëtim nga borxhi. Mustaqet edhe mjekra shënojnë pasuni. Zgjatimi i mjekrës: naltësi. Zbardhim i mjekrës shënon pranimin e lutjes. Në trup po të të bijë a po të të zgjatet leshi shtohet malli. Në kokë zgjatim i leshit: shënon evlat. E thurura lesh: del murat. Dhëmbi po të lëvizë: prapësi. Po të bjenë dhëmbët e sipërme: pasuni. Po të bjenë të poshtmit: humbje edhe zi. Damari shënon personë punëtor. Mëlçija: trimëri. E hangura mëlçi: hazër pasuni.